



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 144

Tiranë – E Premte, 19 Shtator 2014

PËRMBAJTJA

Faqe

Urdhër i IQ
nr. 28, datë 17.4.2014

Për miratimin e Kodit të Etikës për punonjësit e inspektorateve
shtetërore në Republikën e Shqipërisë..... 6615

Urdhër i IQ
nr. 58, datë 21.8.2014

Për miratimin e formateve standard për dokumentimin e veprimtarisë
së inspektimit në Republikën e Shqipërisë..... 6618

**URDHËR**

Nr. 28, datë 17.4.2014

**PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS
PËR PUNONJËSIT E
INSPEKTORATEVE SHTETËRORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 16, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Kodit të Etikës për punonjësit e inspektorateve shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, sipas lidhjes “Kodi i Etikës për punonjësit e inspektorateve shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Kodi i Etikës për punonjësit e inspektorateve shtetërore në Republikën e Shqipërisë është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë punonjësit e Inspektoratit Qendror dhe inspektorateve shtetërore gjatë ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të tyre zyrtare.

3. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe inspektoratet shtetërore për zbatimin e këtij urdhri.

4. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.inspektoratiqendror.gov.al, si dhe u njoftohet inspektorateve shtetërore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**Ilir Zela***Lidhje***KODI I ETIKËS****PËR PUNONJËSIT E INSPEKTORATEVE
SHTETËRORE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Misioni kryesor i veprimtarisë së inspektorateve shtetërore është mbrojtja e interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë, nëpërmjet punës së realizuar me pasion, korrektësi dhe profesionalizëm. Punonjësit e inspektorateve shtetërore, gjatë ushtrimit të funksioneve e detyrave, duhet të reflektojnë përkushtim profesional, standarde të larta të

përgjegjshmërisë dhe respektim korrekt të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim ruajtjen dhe forcimin e besimit tek publiku. Vetëm një performancë e një niveli të lartë në të gjitha drejtimet kontribuon në krijimin e besimit dhe mbështetjes publike.

Për të përmbushur këtë mision, hartohet ky Kod Etike, i cili mishëron vlerat etike në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë e çdo punonjësi të inspektorateve shtetërore në përmbushje të veprimtarisë së tyre të inspektimit.

Kodi nuk përmban përgjigje ndaj të gjitha situatave apo dilemave etike që mund të hasen në praktikë. Ai synon të nxisë reagimet e duhura nga ana e punonjësve të inspektorateve shtetërore bazuar në parimet dhe drejtimit kryesore etike të përmbledhura në Kod. Ai përfaqëson gjithashtu një angazhim të qartë të inspektorateve shtetërore për të përmbushur detyrat që lidhen me veprimtarinë e inspektimit në një nivel të lartë profesional, në respekt të misionit të aktivitetit të tyre.

I. BAZA LIGJORE

Ky Kod hartohet në zbatim të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, akteve ligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

II. QËLLIMI DHE FUSHA E VEPRIMIT

Qëllimi i këtij Kodi Etike është promovimi i rregullave të sjelljes dhe të etikës profesionale për punonjësit e inspektorateve shtetërore, gjatë dhe jashtë ushtrimit të kompetencave të tyre funksionale, në pajtueshmëri me aktet ligjore e nënligjore në fushën e inspektimit, si dhe me rregullat e etikës në administratën publike.

Rregullat e përcaktuara në këtë Kod do të zbatohen për të gjithë dhe nga të gjithë punonjësit e inspektorateve shtetërore gjatë dhe jashtë ushtrimit të funksionit. Kudo që përmendet termi “punonjës” do të nënkuptohen punonjësit e të gjitha niveleve të inspektoratit shtetëror, në veçanti ata që gëzojnë statusin e inspektorit. Termi “inspektoratet shtetërore” përfshin gjithashtu edhe Inspektoratin Qendror.

Rregullat e Kodit vendosin detyrime jo vetëm për punonjësit e inspektorateve, por edhe për vetë institucionet e inspektorateve të cilët duhet të angazhohen në promovimin, njohjen,



kuptimin e saktë dhe zbatimin korrekt të rregullave etike.

III. PARIMET E PËRGJITHSHME

Bazuar në objektivat e procesit të inspektimit, është shumë e rëndësishme që aktiviteti i inspektimit të ndërmerret në mënyrë korrekte dhe të përgjegjshme për të nxitur besimin tek subjektet e inspektimit dhe publiku në përgjithësi.

Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të respektojnë këto parime bazë:

1. Njohuritë dhe kompetenca;
2. Objektiviteti, paanshmëria dhe drejtësia;
3. Përgjegjshmëria dhe integriteti;
4. Ruajtja e informacionit dhe komunikimi me publikun;

5. Paraqitja personale dhe respektimi i ambientit të punës;

6. Konflikti i interesave.

1. Njohuritë dhe kompetenca

1.1 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të synojnë përmirësimin dhe thellimin e njohurive të tyre në mënyrë të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e aftësive profesionale për përmirësimin e shërbimit ndaj komunitetit.

1.2 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të kryejnë detyrën me përkushtim, ndershmëri dhe përgjegjësi, konform akteve ligjore në fuqi. Pjesëmarrja në aktivitete e veprimtari profesionale të cilat synojnë rritjen e njohurive, aftësive dhe kapaciteteve inspektuese e profesionale është mjaft e rëndësishme.

1.3 Punonjësit e inspektorateve shtetërore i nënshtrohen vlerësimit periodik të tyre sipas legjislacionit në fuqi. Aftësitë dhe eksperiencat profesionale të përfituara duhet të vihen në funksion të zbatimit të detyrave dhe përmirësimit të cilësisë së punës.

1.4 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të respektojnë ligjin dhe të kryejnë detyrat në përputhje me legjislacionin në fuqi duke mos penguar zbatimin e politikave të inspektimit të autoriteteve të inspektorateve shtetërore, Inspektoratit Qendror dhe autoriteteve të tjera publike.

1.5 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të respektojnë marrëdhëniet hierarkike me eprorët, vartësit e kolegët e të njëjtit nivel hierarkik, në funksion të arritjes së qëllimit të

përbashkët të inspektimit dhe mbajtjes së marrëdhënieve korrekte me subjektet e inspektimit.

2. Objektiviteti, paanësia dhe drejtësia

2.1 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të trajtojnë me respekt dhe objektivitete subjektet e inspektimit dhe të tregojnë kujdes në procedurën e inspektimit, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me ligjin.

2.2 Të gjitha subjektet e inspektimit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, me standarde të njëjta duke parandaluar çdo qëndrim diskriminues. Duhet të shmangen sjellje të paqarta dhe të dyshimta.

2.3 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të mbështeten tek baza ligjore për mbledhjen, vlerësimin, gjykimin dhe përpunimin e informacioneve dhe të dhënave që lidhen me inspektimin. Ata nuk duhet të influencohen nga interesi personal ose i të tjerëve në formulimin e vendimeve të tyre në fund të procesit të inspektimit.

3. Përgjegjshmëria dhe integriteti

3.1 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të reflektojnë standarde të larta të integritetit personal e profesional në ushtrimin e funksioneve të tyre, duke zbatuar me përgjegjësi vetëm aktivitetet e parashikuara në kuadrin ligjor përkatës, për t'u siguruar që procesi të kryhet në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme.

3.2 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të përdorin autoritetin në mënyrë të përgjegjshme dhe korrekte duke respektuar të drejtat e subjekteve të inspektimit dhe individëve të tjerë.

3.3 Punonjësit e inspektorateve shtetërore në kryerjen dhe përmbushjen e detyrave të ngarkuara duhet të bëjnë përpjekjet maksimale për zbatimin me profesionalizëm të aftësive të tyre bazuar në eksperiencën përkatëse.

4. Ruajtja e informacionit dhe komunikimi me publikun

4.1 Çdo punonjës i inspektorateve shtetërore, që has të dhëna personale dhe konfidenciale të subjekteve të inspektimit, duhet t'i përdorë ato vetëm nëse i nevojiten për realizimin e detyrave funksionale.

4.2 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të garantojnë mbrojtjen e informacionit që



marrin dhe të mos e bëjnë atë publik pa autorizimin përkatës, përveç rasteve kur ka detyrim ligjor për ta bërë atë. Ata duhet të ruajnë informacionin e mbledhur për shkak të detyrës funksionale apo detyrës së ngarkuar dhe nuk duhet ta përdorin atë për përfitim personal, në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e etikës.

4.3 Përveç detyrimit për të ruajtur fshehtësinë, çdo punonjës duhet të marrë masa të parandalojë dhe të mbrojë rrjedhjen e informacionit. Informacioni dhe të dhënat sensitive dhe konfidenciale nuk duhet të lihen pa mbrojtur dhe duhet të merren masat e nevojshme që të respektohen detyrimet ligjore për mosnxjerrjen apo publikimin e informacionit jopublik.

4.4 Çdo punonjës gëzon lirinë e opinionit personal, por duhet të respektojë ruajtjen e konfidencialitetit në qëndrimet apo deklaratat me mediat e shkruara dhe elektronike, dhe përgjithësisht gjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksionit në zbatim të rregulloreve të institucionit dhe parashikimeve ligjore.

4.5 Punonjësit e inspektorateve shtetërore nuk duhet të bëjnë në publik komente të papërshtatshme, të tilla si: vërejtje mbi politikën ose programe të inspektoratit shtetëror përkatës; deklaratat apo opinione personale që mund të interpretohen si zyrtare; sulme kundër administratës së inspektoratit shtetëror përkatës ose punonjësve të tjerë të inspektorateve shtetërore, etj.

4.6 Nëse punonjësi i inspektoratit shtetëror, për arsye të shkeljeve të konstatuara gjatë kryerjes së detyrave, është njoftuar nga prokuroria për fillimin e hetimit të një çështjeje penale ndaj tij, ai/ajo duhet që brenda 24 orëve pas marrjes së njoftimit të vërë në dijeni eprorin e tij, si edhe drejtorinë përkatëse që mbulon burimet njerëzore pranë inspektoratit shtetëror përkatës.

5. Paraqitja personale dhe respektimi i ambientit të punës

5.1 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të kenë një sjellje të mirë dhe të denjë në të gjitha rrethanat, me qëllim respektimin e moralit dhe ligjit gjatë ushtrimit të funksionit.

5.2 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të paraqiten me veshje serioze, në respekt të autoritetit institucional.

5.3 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të respektojnë dhe zbatojnë me efektivitet

orarin e punës. Rastet e mosparaqitjes në detyrë duhet të shoqërohen me justifikim të arsyeshëm.

5.4 Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të mbajnë në mënyrë të ekspozuar kartën e inspektorit (në rastin e atyre punonjësve që gëzojnë statusin e inspektorit) ose kartën e punonjësit.

5.5 Punonjësit e inspektorateve shtetërore nuk duhet të konsumojnë pije alkoolike, duhan, etj., gjatë procedurës së inspektimit, në vendin e inspektimit dhe ambientin e punës.

5.6 Punonjësit e inspektorateve shtetërore nuk duhet të gjykojnë e veprojnë mbi baza diskriminuese (për arsye race, përkatësie fetare, gjinore, pozite sociale, orientimi seksual, etj.) si brenda, dhe jashtë ambienteve të punës.

5.7 Punonjësit e inspektorateve shtetërore kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitetin e tyre në ambiente të shëndetshme dhe të sigurta. Ata duhet t'i zbatojnë rigorozisht rregullat që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë dhe duhet t'i raportojnë menjëherë eprorit të drejtpërdrejtë për çdo problem shëndeti dhe sigurie.

5.8 Punonjësit e inspektorateve shtetërore duhet të jenë të kujdesshëm në përdorimin e mjeteve dhe pronës së institucionit. Nuk duhet të përdorin mjetet institucionale për qëllime apo përdorim privat.

6. Konflikti i interesave

6.1 Inspektorët duhet të njohin dhe zbatojnë me korrektësi detyrimet e kuadrit ligjor që lidhen me parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrave të tyre. Ata duhet të garantojnë mbrojtjen e interesit publik në gjithë aktivitetin e tyre, duke shmangur çdo sjellje që mund të komprometojë integritetin dhe besueshmërinë e publikut.

6.2 Për të shmangur konfliktin e interesit dhe rrezikun e përdorimit të gabuar të informacionit, është e nevojshme që punonjësit të këshillohen me drejtuesit.

6.3 Inspektorët e inspektorateve shtetërore nuk mund të zotërojnë asnjë aksion ose pjesë në kapital në shoqëritë tregtare që ushtrojnë veprimtari në fushën dhe territorin e juridiksionit të inspektoratit shtetëror përkatës ku ushtron funksionet ky inspektor. Për inspektorët e inspektoratit shtetëror në nivel qendror, juridiksion territorial vlerësohet i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.



6.4 Inspektorët e inspektorateve shtetërore nuk mund të administrojnë, ndikojnë, orientojnë subjektin e inspektimit në veprimtarinë e tij, si dhe nuk mund të inspektojnë persona të lidhur me ta sipas kategorive të parashikuara në ligjin nr. 9367 datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Nëse gjatë ushtrimit të funksionit, inspektori vëren se ka marrëdhënie të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me subjektin e inspektimit, duhet ta deklarojë atë tek eprori direkt.

6.5 Inspektorët e inspektorateve shtetërore nuk mund të marrin pjesë në aktivitete ose marrëdhënie të cilat janë në konflikt interesi me të qenit inspektor i inspektoratit shtetëror përkatës. Ata nuk mund të ushtrojnë veprimtari private që krijojnë të ardhura në formën e personit fizik, ortakëri personash fizikë, tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, noterisë, ekspertit të licencuar, si edhe të konsulentit, agjentit ose të përfaqësuesit të organizatave.

6.6 Inspektorët e inspektorateve shtetërore mund të punësohen vetëm në procese mësimdhënieje, pasi për këtë të kenë marrë pëlqimin e eprorit të drejtpërdrejtë, bazuar në kërkesën me shkrim që përmban përshkrimin e saktë të aktivitetit, vendin (institucionin), kohëzgjatjen, shpeshhtësinë dhe pagesën.

6.7 Kërkimi dhe pranimi i çdo shpërblimi për shkak të pozicionit në inspektoratin shtetëror, është e papajtueshme dhe përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore dhe procedim penal.

6.8 Inspektorët kanë detyrim të plotësojnë me shkrim formularin e konfliktit të interesit dhe ia dorëzon atë eprorit direkt, para marrjes së detyrës për zbatim.

6.9 Inspektorët kanë detyrim të përmbushin çdo kërkesë tjetër sipas parashikimeve përkatëse të ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

III. AKTIVITETE JASHTË OBJEKTIT TË VEPRIMTARISË SË PUNËS

1. Të gjithë punonjësit e inspektorateve shtetërore ndalohen të bëjnë gjatë orarit të punës propagandë politike.

2. Punonjësve të inspektorateve shtetërore u ndalohet:

- Mbajtja gjatë punës e shenjave të partive ose organizatave politike;

- Shpërndarja e materialeve propagandistike në ambientet e inspektorateve shtetërore apo subjekteve të inspektimit;

- Përdorimi i ambienteve të punës për aktivitet politik;

- Diskutimi gjatë orarit të punës për tema politike;

- Pjesëmarrja më uniformë ose civil në manifestime politike.

3. Nuk u këshillohet punonjësve të kryejnë midis tyre operacione financiare me karakter privat. Ky rekomandim vlen gjithashtu për dhënien e huave një kolegu ose garantimin e huamarrjeve.

IV. APLIKUESHMËRIA DHE ZBATIMI I RREGULLAVE TË KODIT TË ETIKËS

1. Njohja dhe zbatimi me përpikëri i rregullave etike të përcaktuara në këtë Kod, është shumë e rëndësishme për arritjen e objektivave nga të gjithë inspektorët, për të rritur autoritetin e inspektorateve shtetërore dhe mirëbesimin e publikut.

2. Sjelljet që nuk janë përmendur në nenet e këtij Kodi, mund të konsiderohen gjithsesi si cenim i rregullave të etikës nëse vlerësohet se ndikojnë në besimin e publikut dhe reputacionin e institucionit.

3. Moszbatimi i këtyre rregullave do të vlerësohet dhe ndiqet sipas procedurës së parashikuar në rregulloret e brendshme dhe aktet ligjore në fuqi, duke parashikuar kështu masat përkatëse disiplinore.

URDHËR

Nr. 58, datë 21.8.2014

PËR MIRATIMIN E FORMATEVE STANDARD PËR DOKUMENTIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTIMIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në zbatim të nenit 16, pika 2, germa “c” dhe nenit 28, pika 4, të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formateve standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë sipas formateve të



aneksit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Formatet standarde për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga inspektoratet shtetërore gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të inspektimit.

3. Inspektoratet shtetërore, në përputhje me veçoritë dhe kërkesat e legjislacionit të tyre specifik, të përshtatin formatet e tyre të dokumentimit të veprimtarisë së inspektimit, sipas fushave të inspektimit që mbulojnë, si dhe përmbajtjen e hollësishme të autorizimit për çdo funksion inspektimi.

4. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe inspektoratet shtetërore për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror, www.inspektoratiqendror.gov.al, si dhe u njoftohet inspektorateve shtetërore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Ilir Zela



Formati 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX
DEGA RAJONALE E QARKUT _____

AUTORIZIM INSPEKTIMI

Nr. III/00000007/A

Datë ____ / ____ / ____

Bazuar në nenin 27 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM për krijimin e inspektoratit shtetëror përkatës autorizoj inspektimin e

Të dhëna mbi subjektin e inspektimit:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Përshkrim i objektit të inspektimit: (Sigurimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore.....)

Inspektorët shtetëror të autorizuar për të kryer inspektimin:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

si dhe persona të tjerë të autorizuar;

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Kohëzgjatja e inspektimit: _____

(Me selektim në sistem: 1/2, 1 e ½ - 15 ditë)

(ora, data e fillimit)

(ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet ku do të kryehet inspektimi (adresa/t): _____

Njoftim paraprak i autorizimit subjektit të inspektimit: Po ☐ Jo ☐

Njoftimi paraprak i autorizimit nuk njoftohet për arsye: (neni 27 pika 2, germa a/b gjenerohet nga sistemi) _____

KRYINSPEKTORI
(sipas VKM për krijimin e ISH)

Nënshkrimi, Vula e institucionit



Formati 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

PROCESVERBAL INSPEKTIMI

Nr. III/00000007/PV

Datë ____/____/____/

Bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Emri i Punëdhënësit: _____

Kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektimit: (gjenerohen nga sistemi, autorizimi)

(ora, data e fillimit)

(ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

Njoftim paraprak lënë subjektit :

Po ☐Jo ☐

Inspektim me autorizim:

Po ☐Jo ☐

(N.q.s. jo, do zgjidhet nga sistemi një nga gerrat e nenit 27 pika 2 të ligjit 10 443)

Lloji i autorizimit: autorizim i afishuar:

Po ☐Jo ☐

Hyrja dhe inspektimi forcërisht në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit:

Po ☐Jo ☐

(N.q.s Po të plotësohet si më poshtë arsyetimi sipas ligjit të posaçëm për policinë e shtetit dhe të ketë hapësirë për ngarkim dokumenti shpenzimi)

Përfashtimi i përfaqësuesit të subjektit të inspektimit:

Po ☐ Jo ☐

(Nqs Po të plotësohet si më poshtë)

Arsyetimi i përfashtimit:

Procesverbali mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



Masa urgjente:Po ☐ Jo ☐

(Nqs Po të plotësohet si më poshtë dhe hapësirë për ngarkimin e vendimit të ndërmjetëm në sistem)

II. PROCEDURA E INSPEKTIMIT**1. Mostra të marra:**Po ☐ Jo ☐

(nqs Po më poshtë do të gjenerohet nga sistemi tabelat e mëposhtme në varësi të Inspektortit Shtetëror përkatës)

TABELA E MARRJES SË MOSTRAVE

TABELA (për kryerjen e ekspertizave të tjera të nevojshme për verifikimin e produkteve, pajisjeve, proceseve apo makinerive)

2. Dokumente të marra:

Nr.	DOKUMENTI I MARË DHE PËRSHKRIMI	NR. FLETËVE
1		
2		

3. Vendim për sekuestrim dokumentacioni: (ngarkohet në sistem)

Nr.	DOKUMENTI I SEKUESTRUAR DHE PËRSHKRIMI	NR. FLETËVE
1		
2		

4. Detyra të parealizuar nga inspektimi i mëparshëm:

5. Detyrimi i subjektit për paraqitje në zyrën e inspektoritPo ☐ Jo ☐

(Nenin 33, Pikat 1/b, dhe 2 të ligjit nr. 10 433 , datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në RSH”, si dhe parashikimit të ligjit të veçantë)

Procesverbali mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



Përfaqësuesi i autorizuar i subjektit _____, më date ____/____/____; ora _____ të paraqitet në adresën: _____ për vazhdimin e procedurës së inspektimit.

6. Dokumentacioni dhe sendet që duhet të paraqesni:

Dokumente të paraqitura:

Nr.	DOKUMENTI DHE PËRSHKRIMI	NR. FLETËVE
1		
2		

Sendet të paraqitura:

Nr.	SENDI DHE PËRSHKRIMI	COPË
1		
2		

Mosparaqitja do të konsiderohet pengim në kryerjen e detyrës së Inspektorit Shtetëror referuar nenit 54, të ligjit 10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimin në RSH".

7. Gjetjet e konstatuara

Ka shkelje të kërkesave ligjore:

Po ☐

Jo ☐

(Nqs Jo, ky procesverbal konsiderohet edhe si vendim përfundimtar)

(Nqs po të plotësohet si më poshtë)

Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve:

8. Njoftimi i procesverbalit të subjektit të inspektimit

Për faktet dhe rrethanat e konstatuara të paraqitura në këtë procesverbal, subjekti mund të paraqesë shpjegimet apo kontestimet e tij me shkrim ose me gojë pranë Inspektoratit Shtetëror, brenda __ ditëve nga data e njoftimit të këtij procesverbal.

Me përfundimin e këtij afati, do të merret vendimi përfundimtar i inspektimit.

Bashkëlidhur listë verifikimi i plotësuar gjatë inspektimit.

9. Në rast se nuk konstatohen shkelje të jepen arsyet e përfundimit të procedimit.

Procesverbali mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



III. KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. ____ datë ____/____/____/ nenit/eve ____ ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:
 - a. _____;
 - b. _____;
2. Dënim administrativ plotësues:
 - a. _____;
 - b. _____;
 - c. _____;

Shkeljet e kërkesave ligjore për t'u korrigjuar:

Bashkëlidhur listë-verifikimi i plotësuar gjatë inspektimit

IV. VENDIMI PËRFUNDIMTAR

Vendim përfundimtar i veçantë

Po ☐

Jo ☐

Nëse Po Vendimi përfundimtar ngarkohet në sistem.

Nëse Jo Vendimi përfundimtar kur nuk janë konstatuar shkelje ligjore, pasqyrohet më poshtë:

V. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt sot më datën ____/____/____/ dhe pasi lexohet nënshkruhet si më poshtë:

Inspektori/ët Shtetëror

Personi i autorizuar nga subjekti

Procesverbali i njoftohet subjektit brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit.

Procesverbali mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



Formati 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

PROCESVERBAL INSPEKTIMI
(I POSAÇËM)

Nr. IIL/00000007/PV

Datë ____/____/____/

Bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Emri i Punëdhënësit: _____

Kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektimit: (gjenerohen nga sistemi, autorizimi)

(ora, data e fillimit)

(ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

Inspektim me autorizim të posaçëm: Po ☐ Jo ☐
(N.q.s. po, do zgjidhet nga sistemi një nga gjerat, a ose b, të nenit 27 pika 2 të ligjit 10 443)

Lloji i autorizimit: autorizim i afishuar: Po ☐ Jo ☐

Hyrja dhe inspektimi forcërisht në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit:

Po ☐ Jo ☐

(N.q.s. Po të plotësohet si më poshtë arsyetimi edhe sipas ligjit të posaçëm për policinë e shtetit, si dhe të ketë hapësirë për ngarkim të dokumentit të shpenzimeve)

Përjashtimi i përfaqësuesit të subjektit të inspektimit:

Po ☐ Jo ☐

(Nqs Po të plotësohet si më poshtë)



Arsyetimi i përjashtimit:

II. PROCEDURA E INSPEKTIMIT

1. Gjetjet e konstatuara gjatë këtij inspektimi ;

Ka shkelje të kërkesave ligjore:

Po ☐

Jo ☐

(Nqs Po të plotësohet si më poshtë)

Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve :

2. Masa urgjente:

Po ☐

Jo ☐

(Nqs po të plotësohet më poshtë dhe hapësirë për ngarkimin e vendimit të ndërmjetëm)

3. Detyra të parealizuara nga inspektimi i mëparshëm:

4. Shpjegime dhe kontestime të subjektit për faktet dhe rrethanat e konstatuara:

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, hartoi procesverbalin e inspektimit dhe ia njoftoi atë subjektit të inspektimit. Subjekti i inspektimit pati kontestimet si më poshtë vijon:

Dokumentat e paraqitura nga subjekti ngarkohen në sistem

5. Shkelje të kërkesave ligjore:

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore, *(emërtesa e ligjit, nenit, pikës, germës)*:

III. KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr.____ datë __/__/____/ nenit/eve _____ ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

Procesverballi mbahet në tri kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



1. Dënim administrativ kryesor:

- a. _____;
b. _____;

2. Dënim administrativ plotësues:

- a. _____;
b. _____;
c. _____;

Shkeljet e kërkesave ligjore për t'u korrigjuar:

Bashkëlidhur listë-verifikimi i plotësuar gjatë inspektimit

IV. VENDIMI PËRFUNDIMTAR

1. Vendimi përfundimtar në rastet e marrjes aty për aty, në përfundim të inspektimit *(sipas parashikimeve të ligjit të posaçëm)*

V. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt sot më datën ____/____/____/ dhe pasi lexohet nënshkruhet si më poshtë:

Inspektori/ët Shtetëror

Personi i autorizuar nga subjekti

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Procesverbali mbahet në tri kopje dhe nënshkruhet nga inspektorët që e mbajnë atë.



Formati 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

**VENDIMI I NDËRMJETËM
PËR
MARRJEN E MASËS URGJENTE**

Nr. III/00000007/VN

Datë ____/____/____/

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja : _____

Emri i Punëdhënësit: _____

Në bazë të gërmës _____ (a ose b, në varësi të rastit përzgjidhet nga sistemi) të pikës 1 të nenit 43 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, merret masa urgjente si më poshtë: (gërmat nga a-e të pikës 2 të nenit 43 përzgjidhen nga sistemi)

Kohëzgjatja e afatit të masës urgjente :

(ora, data e fillimit)

(ora, data e përfundimit)

Shënim:

Vendimi i ndërmjetëm përfundon automatikisht me kalimin e afatit të parashikuar në të dhe, kur nuk është përcaktuar një afat i tillë, me:

- a) njoftimin e revokimit të tij;
- b) njoftimin e përfundimit të procedimit apo njoftimin e vendimit përfundimtar, që nuk konstaton shkelje të kërkesave ligjore;
- c) skadimin e afatit për njoftimin e vendimit përfundimtar të inspektimit pa një vendim të tillë;
- ç) njoftimin e vendimit të zgjidhjes së ankimit ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit në rastin kur është bërë ankimi;
- d) skadimin e afatit për paraqitjen e ankimit administrativ ndaj vendimit përfundimtar pa bërë ankim;
- dh) urdhërimin shprehimisht me vendim gjyqësor.

Inspektorët Shtetëror të autorizuar :

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

*Ky vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente njoftohet brenda 24 orëve.

**Kundër vendimit të masës urgjente, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm dhe nuk pezullon ekzekutimin e tij. Ankimi i veçantë paraqitet pranë degës territoriale të Inspektoratit Shtetëror përkatës.



Formati 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____/

Bazuar në nenin 46 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. _____, datë ____/____/____/, të zhvilluar në subjektin _____
prej datës ____/____/____/ deri më datën ____/____/____/.

(kjo pjesë plotësohet nga sistemi)

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datë ____/____/____/ dhe e njoftoi në datë ____/____/____/.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore (emërtesa e ligjit, nenit, pikës, germës të cilat merren nga procesverbali i inspektimit):

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit/ve nr. ____ nenit/eve ____ pikës ____ germës ____, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor: (përzgjidhen nga sistemi)
 - a. _____;
2. Dënim administrativ plotësues: (përzgjidhen nga sistemi)
 - a. _____;
 - b. _____;

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive: (përzgjidhen nga sistemi)

Ngarkohet në sistem fleta shoqëruese e këshillimit me shkrim për subjektin për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.



Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave. (sipas VKM përkatëse për marrjen e mostrave, me përzgjedhje nga sistemi)

Inspektorët Shtetëror të autorizuar :

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Kundër Vendimit Përfundimtar të inspektimit, subjekti _____ ka të drejtën e ankimit brenda 1 muaji nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar.

Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror” të Inspektoratit Shtetëror të xxx.

Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.



Formati 6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

VENDIMI
PËR
ZGJIDHJEN E ANKIMIT TË VEÇANTË

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____/

(Emërtimi i inspektoratit shtetëror)

(Në rast të degëve territoriale - Dega)

Në bazë të pikës 2 të nenit 44 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Ankimit të Veçantë nr. _____, datë _____, i subjektit _____ (emërtimi i subjektit që është ankuar), (kjo pjesa plotësohet nga sistemi)

Pasi shqyrtova ankesën e këtij subjekti dhe masën urgjente të marrë,

VENDOS:

1. Lënien në fuqi të vendimit të ndërmjetëm dhe rrëzimin e ankimit të veçantë
2. Shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm dhe pranimin e ankimit të veçantë
3. Ndryshimin e vendimit të ndërmjetëm, duke pranuar pjesërisht ankimin

☐
☐
☐

Për sa më sipër urdhëroj lënien në fuqi (nëse zgjidhet opsioni 1) / ndërprerjen (nëse zgjidhet opsioni 2) / ndryshimin (nëse zgjidhet opsioni 3) të masës urgjente përkatëse, (gjenerohet nga sistemi germa nga a) në e) të pikës 2 të nenit 43 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”).

KRYINSPEKTORI
(sipas VKM për krijimin e ISH)

Nënshkrimi, Vula e institucionit

Kundër vendimit për zgjidhjen e ankimit të veçantë mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.



Formati 7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

AUTORIZIM PËR NDRYSHIMIN E
INSPEKTORËVE

Nr. III/00000007/A

Datë ____/____/____

(Emërtimi i inspektoratit shtetëror)_____
(Në rast të degëve territoriale - Dega)Ndryshime në Autorizimin nr. Datë *(te gjenerohet nga sistemi autorizimi të cilit i referohet)*

Baza ligjore: Neni 30, pika 3, e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”.

Inspektori/ët e autorizuar:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Zëvendësohen me Inspektorin/ët e autorizuar:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Persona të tjerë të autorizuar :

1. _____

2. _____

Zëvendësohen me:

1. _____

2. _____

KRYINSPEKTORI
(sipas VKM për krijimin e ISH)

*Nënshkrimi, Vula e institucionit**Autorizimi nuk mund të ankimohet veçmas vendimit përfundimtar të inspektimit.*



Formati 8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

**KËRKESË PËR REFUZIM TË
AUTORIZIMIT TË INSPEKTIMIT**

Nr. III/00000007/A

Datë ____/____/____

Drejtuar: Z/Znj. _____
Kryeinspektor (sipas VKM për krijimin e ISH)

Kërkesë për refuzim të Autorizimit nr. _____, datë _____ (plotësohet nga sistemi)

Bazuar në pikën 3, të nenit 30, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën Shqipërisë”, kërkohet refuzimi i Autorizimit nr. _____ datë _____, për arsye, si më poshtë:

1. Konflikt interesi
2. Programim në ...
3. Leje vjetore
4. Paaftësi e përkohshme
5. Etj.

Inspektori shtetëror:

1. _____ ID: _____

Nënshkrimi, data



Formati 9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

KËRKESË PËR SHTYRJE TË
AUTORIZIMIT TË INSPEKTIMIT

Nr. III/00000007/A

Datë ____/____/____

Drejtuar: Z/Znj. _____
Kryeinspektor (sipas VKM për krijimin e ISH)

Kërkesë për shtyrje të Autorizimit nr ____, datë _____

Bazuar në pikën 3, të nenit 29, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën Shqipërisë”, kërkohet shtyrje e kohëzgjatjes së inspektimit, për arsye, si më poshtë:

Kohëzgjatja e inspektimit shtyhet me: _____
(Me selektim në sistem: 1/2, 1 e 1/2 - 15 ditë)

(data e fillimit)

(data e përfundimit)

*Shënim: kohëzgjatja mund të shtyhet me një herë të vetme dhe për një periudhë jo më të madhe se kohëzgjatja fillestare.

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

Inspektorët shtetëror:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Vendimi i njoftohet subjektit të inspektimit përpara skadimit të kohëzgjatjes dhe nuk mund të ankimohet veçmas.



Formati 10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

VENDIM PËR SHTYRJE TË
AUTORIZIMIT TË INSPEKTIMIT

Nr. III/00000007/A

Datë ____/____/____

Bazuar në pikën 3, të nenit 29, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH” dhe kërkesën nr ____ datë ____ (nga sistemi kërkesa e paraqitur nga inspektori shtetëror) autorizoj/nuk autorizoj shtyrjen e kohëzgjatjes së inspektimit, për arsye, si më poshtë:

Të dhëna mbi subjektin e inspektimit:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Përshkrim i objektit të inspektimit: (Sigurimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore.....)

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

(Nëse jepet autorizim për shtyrje të afatit)

Kohëzgjatja e inspektimit shtyhet me (selektim në sistem) _____
(data e fillimit) (data e përfundimit)

Shënim: Kohëzgjatja mund të shtyhet me një herë të vetme dhe për një periudhë jo më të madhe se kohëzgjatja fillestare

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

KRYINSPEKTORI
(sipas VKM për krijimin e ISH)

Nënshkrimi, Vula e institucionit



Formati 11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

VENDIMI I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____

Emërtimi i Komisionit të Ankimit _____
(Emërtimi i inspektoratit shtetëror)

Emri i subjektit që është ankuar të cilit i referohet vendimi përfundimtar *(kjo pjesa plotësohet nga sistemi)*

Në bazë të pikës 2 të nenit 51 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Ankimit për vendimin përfundimtar nr. _____, datë ____/____/____, i subjektit _____ (emërtimi i subjektit që është ankuar), *(kjo pjesa plotësohet nga sistemi)*

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë *(Shpjegimi i fakteve që janë bërë shkak për vendosje të dënimit administrativ)*, Komisionit i ankimit:

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit për vendimin përfundimtar ☐
2. Shfuqizimin e vendimit përfundimtar dhe pranimin e ankimit për vendimin përfundimtar ☐
3. Ndryshimin e vendimit përfundimtar, duke pranuar pjesërisht ankimin për vendimin përfundimtar ☐

Për sa më sipër urdhëroj lënien (nëse zgjidhet opsioni 1) / ndërprerjen (nëse zgjidhet opsioni 2) / ndryshimin (nëse zgjidhet opsioni 3) të masës urgjente përkatëse, *(gjenerohet nga sistemi masa e marrë)*.

KRYINSPEKTORI
(sipas VKM për krijimin e ISH)

Nënshkrimi, Vula e institucionit

Data e hyrjes në fuqi të aktit

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.



Formati 12



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

ANKESË
PËR
VENDIMIN PËRFUNDIMTAR

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____

Drejtuar : Komisionit të Ankimit (Organi Epror)

(Emërtimi i Inspektoratit Shtetëror)

Subjekti ankues: (kjo pjesa plotësohet nga sistemi)

Objekti : Pavlefshmëri/ndryshimi i vendimit përfundimtar nr. ____ datë ____/____/____ (vjen nga sistemi nr ____ datë ____/____/____ i vendimit përfundimtar që ankimohet).

Baza ligjore: neni 51 i Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

1. Faktet dhe shpjegimet në lidhje me to;

2. Baza ligjore e plotë (kjo pjesa plotësohet nga sistemi);

3. Shpjegime të qarta në lidhje me pretendimet.

Emri i plotë i ankuesit (kjo pjesë plotësohet nga sistemi)

Nënshkrimi

Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm, paraqitja e ankimit administrativ pezullon ekzekutimin e vendimit përfundimtar të ankimuar, por nuk cenon ekzekutimin e masave urgjente.



Formati 13



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX

DEGA RAJONALE E QARKUT _____

ANKIMI I VEÇANTË

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____

Drejtuar : Kryeinspektorit/Drejtuesit të degës territoriale (sipas VKM për krijimin e ISH)_____
(Emërtimi i Inspektoratit Shtetëror)_____
(Në rast të degëve territoriale - Dega)Subjekti ankues: (kjo pjesa plotësohet nga sistemi)Objekti : Pavlefshmëria/ndryshimi i vendimit të ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente
nr. ____ datë ____/____/____ (vjen nga sistemi nr datë i vendimit të ndërmjetëm që ankimohet).Baza ligjore: neni 44 i Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

1. Faktet dhe shpjegimet në lidhje me to;

2. Baza ligjore e plotë (kjo pjesë plotësohet nga sistemi);
3. Shpjegime të qarta në lidhje me pretendimet.

Emri i plotë i ankuesit (kjo pjesë plotësohet nga sistemi)

Nënshkrimi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja “Kristalina”
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 28 lekë